



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:109001
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05853249

K.Dh.Sh.II.nr.553/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Ymeri Zhitija ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.R.U “Hidroregjioni Jugor” me seli në Prizren, me NRB: 70433702Sh.A, rruga “Wesley Clark” p.n., Prizren, kundër debitorit Butiku “Rozafa”, Q.I.K. B.I, me seli në Malishevë, F.Rilindja Kombëtare p.n., duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.512/23 të datës 14.11.2023, me datën 24.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e kreditorit K.R.U “Hidroregjioni Jugor” me seli në Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.512/23 të datës 14.11.2023, **PRISHET** dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 512/23 të datës 14.11.2023, e ka pranuar si

të bazuar prapësimin e debitorit Butiku “Rozafa”, Q.I.K. B.I, me seli në Malishevë, F.Rilindja Kombëtare p.n, ashtu që Urdhri Përmbarrimor P.nr. 60/2023, i lejuar më datë 23.02.2023, nga Përmbarruesi Privat Ymer Kastrati, dhe i njejt i urdher Anulohet, dhe Perfundohet P.nr. 60/2023, i lejuar më datë 23.02.2023, nga Përmbarruesi Privat Ymer Kastrati.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, (me pretendime sikurse në ankesë), me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta obligoj debitorin ta paguaj borxhin së bashku me shpenzime të procedurës.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, P.nr. P.nr.60/2023 i datës 23.02.2023, me të cilin ka lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.0006057751, dhe Kartelës Financiare të Konsumatorit me shifër 0006057751 ka caktuar zbatimin e përmbarrimit, ndaj debitorit Z. Q.K., pronar i butikut “Rozafa”, duke e detyruar debitorin që pas pranimit të urdhrin përmbarrimor kreditorit t’ia paguaj shumën e borxhit prej 655.14 €, si dhe të gjitha shpenzimet përmbarrimore , nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin përmbarrimor Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor duke deklaruar se e konteston në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbarrimit duke theksuar se ekzistojnë shkelje të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me parashkrimin e borxhit, dhe sipas kësaj nuk mund të kërkohet ekzekutimi. Tutje ka shtuar se kreditori ka kërkuar përmbarrimin e kontratës së datës 23.09.2014 e cila nuk është as titull përmbarrimor dhe as që dihet për cilën periudhë bëhet fjalë. I ka propozuar gjykatës që të

aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri i Përmbauesit Privat Kreditori në përgjigje në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara ngase kreditori ka si dëshmi kartelen e klientit dhe faturën si dokumente të besueshme sipas LPP-së, ku shihet qartë që borxhi total i debitorit ndaj kreditorit është shuma e lartcekur. Tutje ka shtuar se sa i përket parashkrimit të borxhit, debitori e ka nënshkruar kontratën për pagesën e borxhit, ku i njehti në bazë të nenit 368 të LMD-së, ka ndërprerë dhe ka pranuar borxhin në tërësi. I ka propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit si të pabazuar, dhe ta detyrojë debitorin ta përmbush detyrimin e pagesës së borxhit në emër të ujit të shpenzuar, dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi është në tërësi i bazuar me arsyetim se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbaimit dhe i lejuar me urdhrin e Përmbauesit Privat P.nr.60/2023 të datës 23.02.2023 është përmbushur në tërësi nga debitori. Ky fakt vërtetohet nga fletëpagesa nr. 00000789 e datës 07.03.2023, nga e cila rezulton se debitori e ka përmbushur në tërësi jo vetëm borxhin që rrjedh nga Fatura nr.0006057751 në shumën prej 655.14 €, por e ka përmbushur borxhin në shumën totale prej 694.11 €, dhe këtë përmbushje e ka bërë pasi është njoftuar për procedurën përmbaimore të iniciuar nga kreditori, kjo pasi që debitori, ka rënë në dijeni për urdhrin përmbaimit me datë 02.03.2023, kur edhe e ka pranuar të njëjti. Andaj mbi këtë bazë gjykata vlerëson se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar dhe duke u mbështetur në nenin 71 par.1 nën par.1.2, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se “dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbaues ose urdhri përmbaues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi, pasi 3 që fatura nr.0006057751, në bazë të cilit është lejuar urdhri përmbaimit, tanimë e ka humbur efektin juridik, dhe se Dhoma e shkallës së parë ka vlersuara se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbaimit në rastin konkret, nuk ka tipare të përmbaueshmërisë dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbaimit.

Gjykata Komerciale -Dhoma e shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë tani për tani nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se

aktvendimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me aktvendimin ankimuar KPPP.nr.2314/22 të datës 29.09.2023, me të cilin ka aprovuar prapësimin e debitorit nuk ka vendosur në mënyrë të drejtë pasi që nuk ka vërtetuar se fatura si dokumenti përmbartimor a është përmbush detyrimi në të vërtetë, ngase Gjykata e Shkallës së Parë ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.60/2023, i lejuar më datë 23.02.2023, duke u mbështetur në fletëpagesë nr.00000789 sipas të cilës ka vlerësuar se është përmbush detyrimi në tërësi nga fatura nr.0006057751. Mirëpo në shkresat e lëndës Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka vlerësuar drejtë faktin lidhur me faturën në fjalë, sepse në fletëpagesë nr.00000789 si që shifet nuk është e kuartë se për cilën faturë është përmbush detyrimi sepse numri i faturës me të cilën është cek në këtë fletëpagesë nuk përputhet me numërin e faturës fatura nr.0006057751 po ashtu nuk ceket askund as numëri i konsimatorit e cila është e evidentuar në kartelën financiare të konsumatorit.

Andaj, gjykata e shkallës së parë, nuk ka shqyrtuar drejtë çështjen, gjegjësisht lidhur me konstatimin e pagesës së bërë, andaj, me qëllim të harmonizimit të shkresave në lëndë, gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësoj nëse fletëpagesë nr.00000789 a ka të bëjë me detyrimin me të cilën është kërkuar me propozim gjegjësisht me faturën me nr. 0006057751, ashtu që me qëllim të konstatimit të përmbushjes së detyrimit, të marrë për bazë edhe pretendimet e palëve në procedurë, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë duhet ta këtë parasysh nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili thotë, se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përyjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga gjykata, arsye këto nga të cilat rezulton se aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.*

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në këtë rast nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të aprovuar prapësimin e debitorit prandaj, ankesën e kreditorit e pranoi si të

themeltë dhe çështjen vendosi t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike të vlerësojë dokumentin përmbartimor, eventualisht të hapë edhe seancë për ti vërtetuar pretendimet e palëve në këtë çështje përmbartimore, e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.553/24, me datë 24.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri